



Prishtinë: 05.06.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1163\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1936\_05\_19**;
- Ankesa e NQ "Termokos" e datës **28.05.2019**.

### në seancën e mbajtur më datë 05.06.2019, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHE**t ankesa e konsumatorit N. D. nga Prishtina me shifër të konsumatorit 010256 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1936\_05\_19** i datës 13.02.2019.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28.05.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori N. D. (autorizuesi V. R.), i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori përmes avokatit të tij ka theksuar se kundërshton pjesërisht vendimin ZRRE/DMK\_V\_1936\_05\_19 të datës 08.05.2019 me të cilën nuk është shqyrtuar ankesa e konsumatorit dhe propozon që të ndryshohet vendimi ZRRE/DMK\_V\_1936\_05\_19 ose lënda të kthehet në rishqyrtim apo rivendosje. Konsumatori thekson se konsumatori do të duhej që borxhi t'i shlyhej në tërësi 3580.33€ prej periudhës vitit 1999 deri më 08.01.2015 për arsye të parashkrimit dhe faturimit pa bazë pasi që gjatë asaj periudhe nuk ka pasur shërbim. Konsumatori ka theksuar se vendimi i ZRRE është nxjerrë pasi është detyruar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, por pas afatit të përcaktuar nga gjykata dhe për këtë arsye edhe paditësja ka përsëritur ankesën për nxjerrje të vendimit. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se në vendimin e tyre për konsumatorin kanë aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorës por nuk ka vendosur fare për pjesën tjetër të ankesës së konsumatorit. Andaj konsumatori ka kërkuar nga Bordi që organi i shkallës së dytë duhet të vendos që konform Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore borxhi i energjisë termike prej periudhës 1999 – 08.01.2015 është parashkruar dhe nuk ka bazë për inkasim. Konsumatori për borxhin e krijuar fare nuk ka pranuar shërbim për ngrohje andaj nuk duhet të kërkohet ai borxh. ZRRE është dashur që të zbatoj vendimin e gjykatës dhe jo të sillet sikurse është duke e shqyrtuar ankesën e konsumatorit.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i ZRRE është nxjerrë pasi është detyruar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, por pas afatit të përcaktuar nga gjykata dhe për këtë arsye edhe paditësja ka përsëritur ankesën për nxjerrje të vendimit, Bordi i ZRRE-së thekson se ZRRE me datë 11.04.2019 ka pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Aktgjykimin A.nr.892/15 ku është obliguar që ZRRE brenda afatit 30 ditëve të merr vendim sipas ankesës së konsumatorit. Organi i shkallës së parë në ZRRE, pra Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 08.05.2019 ka nxjerrë vendim ku ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe ka obliguar NQ "Termokos" që konsumatorit me shifër 010256 t'i bëjë zbritjen e tërësishme të faturës për muajin dhjetor 2014, pra konsumatori të mos faturohet fare për këtë muaj dhe shuma e faturuar për këtë muaj t'i zbritet nga borxhi i tërësishëm i konsumatorit ndaj ndërmarrjes. Pra kundërshtimi i konsumatorit nuk qëndron se ZRRE ka tejkuluar afatet e përcaktuara nga gjykata, pasi që vendimi i DMK në ZRRE brenda afatit të përcaktuar nga gjykata ka nxjerr vendim dhe i ka njoftuar të gjitha palët lidhur me vendimin e saj.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se ZRRE nuk ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe propozon që të ndryshohet vendimi ZRRE/DMK\_V\_1936\_05\_19 ose lënda të kthehet në rishqyrtim apo rivendosje, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron pasi që vendimi i organit të shkallës ka shqyrtuar në detaje të gjitha dëshmitë e pranuar nga konsumatori dhe NQ "Termokos", e nëse nuk pajtohet pala atëherë ka mundësi kundërshtimi të vendimit në gjykatë. Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar me kujdes përgjigjen e NQ "Termokos", ankesën e konsumatorit, transaksionet e konsumatorit, dhe bazuar në dëshmitë mund të konkludohet se, NQ "Termokos" nuk ka faturuar fare konsumatorin vetëm për muajt tetor dhe nëntor 2014 për shkak të mungesës së ngrohjes dhe jo për periudhat tjera, përderisa ka bërë pjesërisht zbritjet e lartë-përshkuara në faturim për muajin dhjetor 2014. Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë ka vlerësuar saktë kur për shkak të mungesës së ankesës nr.191 dhe përgjigjes së mangët të NQ "Termokos" ka kërkuar nga NQ "Termokos" të zbres faturën e muajit 12/2014 pasi që nuk mundet me saktësi të konstatohet a ka pasur ngrohje në muajin dhjetor 2014 siç pretendohet nga konsumatori, ndërsa për periudha tjera nuk ka dëshmi se nuk ka pasur ngrohje.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se nuk ka pasur ngrohje dhe nuk duhet të inkasohet borxhi i energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës vërehet qartë se që nga fillimi i faturimit NQ "Termokos" vazhdimisht ka bërë zbritje të faturave të energjisë termike me anë të ditëve pa ngrohje dhe kjo vërehet qartë në transaksionet e konsumatorit, ku në shumë periudha kohore konsumatori ka pasur zbritje të shumta të ditëve dhe është faturuar vetëm për ditët me ngrohje. Madje gjatë analizës së bërë transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka bërë edhe disa pagesa të faturave të energjisë termike edhe gjatë periudhës kontestuese.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.06.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit N. D. (avokatit V. R.)
- NQ. "Termokos", dhe
- Arkivit të ZRRE-së.